

VENDIM
Nr. 245, datë 17.4.2024

PËR PËRCAKTIMIN DHE PËRLLOGARITJEN E TARIFËS, PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE NDIHMËSE, PËR PROKURIMIN PUBLIK NGA SHOQËRIA AKSIONARE SHTETËRORE “OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton tarifatat standarde për çdo shërbim që Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. ofron për autoritetet kontraktore publike, në zbatim të vendimit nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, i ndryshuar, si dhe mënyrën e aplikimit të tyre.

2. Tarifatat standarde specifikohen në aneksin nr. 1, “Lista e tarifave të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Të gjitha autoritetet/entet kontraktore, subjekte të vendimit nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe të gjitha subjektet e tjera publike, për marrje të shërbimit nga OBP sh.a.-ja paraqesin kërkesën për shërbime në rrugë shkresore dhe elektronike në adresën zyrtare të kësaj shoqërie.

4. Për kryerjen e çdo shërbimi në kuadër të veprimtarive ndihmëse, autoriteti /enti kontraktor/ subjektet e tjera publike duhet të kryejnë pagesën e tarifës së kryerjes së shërbimit pranë OBP sh.a.-së, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga lëshimi i faturës nga ana e OBP sh.a.-së.

Fillimi i çdo shërbimi, pjesë në aneksin nr. 1, kushtëzohet nga pagimi i tarifës nga ana e autoritetit/entit kontraktor/subjektit tjetër publik.

5. Nëse Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., gjatë trajtimit të kërkesës, konstaton se nuk është realizuar pagesa e shërbimit, nuk vijon me kryerjen e shërbimit, publikimit, zhvillimit të procedurës së prokurimit, nëse është rasti. Shërbimet realizohen vetëm pasi kërkuar të ketë shlyer tërësisht vlerën e tarifës së shërbimit të kërkuar.

6. Në rast se procedura e prokurimit e filluar është anuluar, por nevoja për zhvillimin e saj mbetet e njëjtë, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. detyrohet të rishpallë procedurën pa tarifë shtesë. Nëse autoriteti/enti kontraktor deklaron se ka humbur nevojën pas anulimit të procedurës, OBP sh.a.-ja ka detyrimin të kthejë gjysmën e vlerës së tarifuar.

7. Të gjitha autoritetet/entet kontraktore përfituese detyrohen të parashikojnë në buxhetin e tyre shpenzimet e nevojshme për shlyerjen e tarifave të shërbimeve ndaj OBP sh.a.-së, në përputhje me parashikimet institucionale vjetore. Për vitin 2024, institucionet përfituese të shërbimit marrin masat për rialokime brenda buxhetit të miratuar.

8. Tarifatat e shërbimit të listuara në aneksin nr. 1 do të jenë objekt rishikimi, bazuar në treguesit financiarë të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a.

9. Ngarkohen Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., Kryeministria, ministrinë e linjës, institucionet në varësi të Kryeministrit e të ministrive të linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS NR. 1
LISTA E TARIFAVE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE NDIHMËSE NGA
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr.	Shërbimi	Tarifa
1	Përgatitja dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit	2.5% e vlerës së fondit të kërkuar për t'u prokuruar për procedura me vlerë deri në 200.000.000 lekë pa TVSH; 5.000.000 lekë për çdo procedurë me vlerë mbi 200.000.000 lekë pa TVSH.
2	Konsulencë për përgatitjen e procedurave të prokurimit publik	7,000 lekë/ora